



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2025

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Varianti A

10 qershor 2025

Gjuhë shqipe dhe letërsi - Arsimi i orientuar (artistik dhe sportiv) dhe arsimi profesional

Shënim: Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdesshëm, sidomos në pyetjet e hapura, të cilat kanë më shumë mundësi përgjigjeje dhe ku nxënësit shprehen shpesh dhe me përgjigje të përafërta.

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

PJESA I

Harta e mendjes

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	C	1 pikë
Pyetja 7	A	1 pikë
Pyetja 8	C	1 pikë
Pyetja 9	A	1 pikë
Pyetja 10	D	1 pikë

Pyetja 11**2 pikë****Model përgjigjeje:****E gabuar:** të largët**E saktë:** të largëta**E gabuar:** time**E saktë:** sime

- 2 pikë** Nëse nxënësi identifikon dy gabimet drejtshkrimore dhe shkruan saktë fjalën e gjetur.
- 1 pikë** Nëse nxënësi identifikon një gabim drejtshkrimor dhe shkruan saktë fjalën e gjetur.
- 0 pikë** Nëse nxënësi identifikon gabimet, por nuk i korrigjon.
- 0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12**2 pikë****Model përgjigjeje:****Karakteristika e paragrafit:** Ndërtohet mbi një fjali të vetme.**Shpjegimi:** Ka funksion lidhës mes dy pjesëve të tekstit. I paraprin idesë që do të shtjellohet në pjesën tjetër të tekstit.

- 2 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigjen e plotë.
- 1 pikë** Nëse nxënësi identifikon karakteristikën ose jep shpjegimin.
- 0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13**3 pikë****Përgjigje e plotë:****Funksioni i përdorimit të thonjzave:** I jep fjalës kuptim të figurshëm dhe ngarkesë emocionale.**Interpretimi:** Sipas autorit fjala sekret thekson idenë se suksesi nuk vjen nga shmangia e vështirësive, por nga përballja me sfidat që në fund na forcojnë si individë. Kjo ide ndihmon lexuesin në zhvillimin e një modeli personal dhe rrit besimin në vetvete.**Përgjigje e pjesshme:**

Suksesi vjen nga përballja me sfidat.

OSE

Nxiti lexuesin drejt një shembulli frymëzues.

- 3 pikë** Nëse nxënësi dallon funksionin e thonjzave dhe interpreton shprehjen dhe ndikimin e saj në jetën tonë.
- 2 pikë** Nëse nxënësi bën interpretimin e plotë.
- 1 pikë** Nëse nxënësi identifikon funksionin e thonjzave.
- 1 pikë** Nëse nxënësi bën interpretimin e pjesshëm.
- 0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 14**3 pikë****Përgjigje e plotë:**

Teksti është organizuar në rend kronologjik.

Detaje: Fragmenti është i ndarë në pjesë të ndryshme ku autori fillon me një kujtim të fëmijërisë dhe kalon në reflektime mbi udhëtimet, zhvillimin personal dhe mundësitë për të përballuar sfidat.

Arsyeja: Kjo strukturë e ndihmon autorin të sjellë shembuj personale që shprien lexuesin nga një moment specifik në një filozofi më të gjerë mbi jetën dhe suksesin.

- 3 pikë** Nëse nxënësi identifikon mënyrën e organizimit të tekstit, gjen detajet dhe shpjegon arsyen.
- 1 pikë** Nëse nxënësi identifikon rendin kronologjik.
- 1 pikë** Nëse nxënësi gjen detaje.
- 1 pikë** Nëse nxënësi shpjegon arsyen.
- 0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15**3 pikë****Përgjigje e plotë:**

Ilustrimi 1: Veta e parë njëjës: Ditën kur mbusha gjashtë vjeç, u zgjova dhe zbulova dhuratën.

Ilustrimi 2: Veta e parë shumës: Ne jetojmë për momente të tilla dhe ato na përcaktojnë jetët. Mësojmë se kush jemi në të vërtetë dhe se çfarë ka vërtet rëndësi për ne.

Shpjegimi: Veta e parë njëjës e bën rrëfimin më subjektiv, më emocional dhe personal, ndërsa veta e parë shumës e bën lexuesin pjesë të rrëfimit, pra është më gjithëpërfshirëse.

- 3 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigjen e plotë.
- 1 pikë** Nëse nxënësi identifikon vetën e parë njëjës.
- 1 pikë** Nëse nxënësi identifikon vetën e parë shumës.
- 1 pikë** Nëse nxënësi shpjegon arsyen duke theksuar kalimin nga njëra vetë te tjetra
- 0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16**3 pikë****Model përgjigjeje:**

Koha e foljes: e kryera e thjeshtë

Funksioni: tregon për një veprim të përfunduar, kohë që çon para veprimin etj.

Ilustrimi: mbusha, zbulova, kërkova etj.

- 3 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigjen e plotë.
- 1 pikë** Nëse nxënësi identifikon kohën e foljes.
- 1 pikë** Nëse nxënësi shpjegon funksionin e saj në tekst.
- 1 pikë** Nëse nxënësi ilustron saktë kohën e foljes.
- 0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

PJESA II**Martesa e Gjeta Basho Mujit**

Pyetja 17	B	1 pikë
Pyetja 18	C	1 pikë
Pyetja 19	B	1 pikë
Pyetja 20	D	1 pikë
Pyetja 21	D	1 pikë
Pyetja 22	A	1 pikë
Pyetja 23	C	1 pikë
Pyetja 24	D	1 pikë
Pyetja 25	D	1 pikë
Pyetja 26	B	1 pikë

Pyetja 27 **3 pikë**

Model përgjigjeje:**Tri momentet kyç të këtij fragmenti janë:**

1. Porosia e Mujit
2. Mosbindja e krushqve
3. Ndëshkimi i zanave

3 pikë	Nëse nxënësi jep përgjigjen e plotë.
2 pikë	Nëse nxënësi identifikon dy nga momentet kyçe.
1 pikë	Nëse nxënësi identifikon një nga momentet kyçe.
0 pikë	Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 28 **2 pikë**

Përgjigje e plotë:**Pasojat e mosbindjes ndaj porosive të Mujit janë:**

- Ngrirja e krushqve dhe ngrirja e kuajve.
- I bajnë krushqt si gurët e bjeshkës.
- I bajnë gjogat si cûjt e rrahit.

2 pikë	Nëse nxënësi jep përgjigjen e plotë.
1 pikë	Nëse nxënësi identifikon një nga pasojat.
1 pikë	Nëse nxënësi ilustron me vargjet përkatëse.
0 pikë	Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 29**-2 pikë****Model përgjigjeje:****Pyetja:** Ça ka ba ai Gjeto Basho Muji?**Funksioni:** Tërheq vëmendjen dhe shton kureshtjen e lexuesit duke e parapërgatitur për situatën që pason.

- 2 pikë** Nëse nxënësi gjen pyetjen retorike dhe funksionin e saj.
1 pikë Nëse nxënësi identifikon pyetjen.
1 pikë Nëse nxënësi thotë funksionin.
0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30**2 pikë****Model përgjigjeje:**

Muji është paraqitur si një figurë heroike që ka përvojë dhe i njeh mirë forcat natyrore dhe magjike. Përshkruhet si njeri që njeh mirë rreziqet e natyrës i matur, i kujdesshëm, që respekton traditat, prandaj porosit kreshnikët për këto rreziqe.

Ilustrimi:

Po ndigjoni, o krushq darsmorë
Kur të delni n'maje t'bjeshkës,
Aty janë tri mrize t'mdha,
Njaty rueni se lodroni,
Njaty kangën mos e e kndoni,
Se aty janë tri zana t'idhta,

- 2 pikë** Nëse nxënësi dallon tiparin duke e ilustruar me vargje.
1 pikë Nëse nxënësi identifikon tiparin.
1 pikë Nëse nxënësi ilustron me vargjet e dhëna më lart.
0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 31**2 pikë****Model përgjigjeje:**

Anafora: Kanë nisë kangën e po këndojnë,
 Kanë nisë lodrën e po lodrojnë,
 Kanë nisë gurrat e po i turbullojnë,

Pranohet çdo rast tjetër i përdorimit të anaforës.

Funksioni: I jep fragmentit ritëm dhe muzikalitet.

- 2 pikë** Nëse nxënësi identifikon figurën dhe thotë funksionin e saj.
1 pikë Nëse nxënësi identifikon anaforën.
1 pikë Nëse nxënësi thotë funksionin e saj.
0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 32**2 pikë****Model përgjigjeje:**

Elemente fantastike: Prania e personazheve mitologjike, siç janë zanat; përdorimi i hiperbolës; ngrirja e krushqve dhe e kuajve.

- 2 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigjen e plotë.
1 pikë Nëse nxënësi identifikon një element.
0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Pranohet përgjigja edhe nëse nxënësi i gjen elementet fantastike vetëm duke i ilustruar me vargjet.

Pyetja 33**3 pikë****Model përgjigjeje:**

Gjatë përshkrimit nxënësi mund të ndalet në cilësitë e zanave, në veprimet e tyre, në shfaqjen e befasishme etj. Nxënësi duhet të përdorë një gjuhë përshkuese dhe leksik të zgjedhur. Mund të shfrytëzojë disa nga detajet më poshtë.

Të rrezikshme, ndëshkuese, mbrojtëse të mrizeve etj.

Shembuj: T'ria qesin zjarm për gojet

I bajnë krushqt si gurët e bjeshkës etj.

- 3 pikë** Nëse nxënësi bën përshkrim të plotë duke u ndalur edhe në detaje.
2 pikë Nëse nxënësi përshkruan një cilësi të zanave duke e shoqëruar me detajin përkatës.
1 pikë Nëse nxënësi përshkruan vetëm një cilësi të zanave ose jep vetëm një detaj.
0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

PJESA III**Pyetja 34****8 pikë**

Për pjesën ese do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme:

Shtjellimi i idesë**2 pikë**

- shkruan një ese, e cila mbështetet në thënien e G. Kasparov, në ngjarje të dëguara dhe të lexuara ose në çdo përvojë personale të nxënësit;
- shtjellon përjetime nga ngjarje të cilat i kanë ndikuar në jetë;
- shtjellon ngjarje që i kanë ndryshuar këndvështrimin për botën;
- sjell përfytyrime në formën e historive të krijuara;
- zbërthen bërthamën e kësaj teme të jashtëzakonshme.

Organizimi dhe struktura**2 pikë**

- përdor strukturë të qartë eseje: hyrje – zhvillim – mbyllje;
- siguron kalimin rrjedhshëm në paragrafët zhvillues;
- grupon çështjet në paragrafë të organizuar drejt, qartë, saktë dhe në mënyrë të plotë e të logjikshme;
- zgjedh dhe përdor konektorët e duhur për të siguruar koherencën dhe kohezionin e tekstit. Këta janë të shumëllojshëm dhe i shmangen fjalorit të gjuhës së përditshme;
- përcjell konkluzionin personal në raport me temën (paragrafi përmbyllës).

Stili dhe origjinaliteti**2 pikë**

- përdor një gjuhë të qartë dhe origjinale, për krijimin e një përshtypjeje të plotë për atë që shprehet në raport me temën;
- përdor një gjuhë të pasur me detaje të shumta që mbështetin idenë dhe që ndikojnë dhe vënë në lëvizje imagjinatën e lexuesit;
- përdor gjuhë subjektive dhe shpesh format shpjeguese gërshetohen me detaje përshkuese;
- përdor fjalor të pasur dhe të shumëllojshëm, me shprehje të zgjedhura që sigurojnë origjinalitet në shkrim dhe dëshmojnë për një formim të mirë jo vetëm letrar, por edhe gjuhësor.

Saktësia gjuhësore**2 pikë**

- përdor drejt struktura të fjalive, të cilat mbështetin nga pikëpamja gjuhësore përmbajtjen e esesë; - - -
- shkruan pa gabime fjalë të përdorimeve të shpeshta (ose jo), si dhe ndërton drejt, sipas kuptimit apo kumtimit, të gjitha llojet e fjalive;
- përdor saktë shenjat e pikësimit, të të gjitha llojeve: pikë, presje, dy pika, pikëçuditëse, pikëpyetje, vizë ndarëse etj, gjë që dëshmon për njohje shumë të mirë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- shkruan saktë nga pikëpamja e drejtshkrimit, sintaksës e pikësimit, gjë që mbështet në mënyrë të plotë strukturën e fjalive.

Shënim: Në vlerësimin e esesë, rubrikat që do të vlerësohen nuk mund të shihen të palidhura me njëra-tjetrën, pasi ato nuk mund të kenë një mëvetësi të plotë, ato shihen në harmoni. Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përpjekje të nxënësit.